



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 5, 45 dhe 90 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 9 dhe 10 të Rregullës Zgjedhore nr. 09/2009 “Votimi dhe Numërimi brenda Vendvotimeve”, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 04.11.2009 miratoi këtë:

UDHËZIM PËR KVV-të

Për pranimin e Dokumenteve të Identifikimit të Votuesve për Zgjedhjet Lokale 2009

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Udhëzon anëtarët e KVV-ve që Ditën e Zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009 të pranojnë Dokumentet e Identifikimit të votuesve *si në vijim*:
 1. Letërnjoftimi i vlefshëm;
 2. Pasaporta e vlefshme;
 3. Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit;
 4. Leja e vozitjes e vlefshme e Kosovës;
 5. Kartela e vlefshme e Personave të Zhvendosur Brenda Vendit (PZHBV) dhe
 6. Kartela e vlefshme e Refugjatit
- II. Të gjitha dokumentet e sipërpërmendura janë të vlefshme dhe votuesit që i posedojnë mund të votojnë pavarësisht skadimit të afatit të tyre.
- III. Ky Udhëzim është i obligueshëm për të gjithë anëtarët e KVV-ve në territorin e Republikës së Kosovës, dhe zbatohet Ditën e Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit 2009 si dhe për votim në Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave.
- IV. Ky Udhëzim duhet t’u dërgohet anëtarëve të KVV-ve Ditën e Zgjedhjeve.

Prishtinë, 04.11.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve